

Oda e Stomatologeve te Kosovës (OSK)

Raport i auditimi funksional i Organeve të OSK-së

/për Pasqyrat Financiare 2020/

Bazuar ne Specifikimet teknike të paraqitura ne Dosjen e tenderit se OSKsë përveq dhenies së Opinionit për Pasqyrat fianciare 2020 të Odës së Stomatologeve të Kosovës (OSK) konform Standardeve Nderkombetare të Auditimit (SNA) , kemi marrë përgjegjësinë të kryejmë auditimin funksional të Organeve të OSK-së e cila njeherit është pjesë përberëse e Raportit të Auditorit .

Ne këtë Raport të perfomancës do të prezentojm gjetjet që nuk vlersohen si materiale por me shumë janë si mosrespektim i parimeve dhe rregolloreve ne disa raste. Krahas gjetjeve ne kemi sqaruar ndikimin e ketyre gjetjeve ,pasojat e mundshme si dhe rekomandimin për këto gjetje.

Ne vijim ju prezentojmë gjetjet lidhur pasqyart financiare 2020 si dhe vlersimet tona lidhur me punen e organeve të OSK-së për këtë periudhë.

II. Raporti auditimit funksional (performancës) të organeve të OSK-së

Sipas kërkeses së Odës dhe duke u bazuar ne Ligjin Nr.04/L-150 për Odat Profesionale Shëndetësore , Statutin e OSK-së ne kemi marrë persipër që të auditojmë performancën e organeve të OSK-së për periudhën 2020.

Konform nenit 18 të Statuti të OSK -së , Oda ka të themeluar keto organe :

- ❖ Kuvendin ,
- ❖ Kryetari Odes ,
- ❖ Keshilli Drejtues ,
- ❖ Keshilli mbikqyres,
- ❖ Keshilli Etik, Gjyqi i nderit, Prokurori i Odës dhe
- ❖ Komisionet e përhershme

Mbeshtetur ne nenin 47 të Statutit Oda ka për obligim tansparencën dhe raportimin për punën e Organeve dhe Komisioneve të perhershme të OSK-së.

Gjatë verifikimit të deshmive lidhur me zbatueshmërisë së akteve normative nga ana e organeve të OSK-së ne mund të konstatojmë me sa vijon :

1. Për **Kuvendin** si organi me i lartë i OSK-së gjatë auditimit nuk kemi verejtur parregullësi që meriton të theksohet , nderkaq pamë se jnaë zbatuar kompetencat e tij qe dalin nga nenit 20 i Statutit të OSK-së, duke potencuar fillimisht me zgjedhjen e të gjitha Organeve të OSK-së ne mbledhjet e mbajtur me 23 Prill dhe 14 Maj 2019 . Pastaj për të ngritur e transparencën dhe llogaridhenien OSK ka berë lansimin e web-faqës ku janë publikuar të gjitha informatat rreth Odës.
2. **Kryetari** i OSK-së bazuar ne verifikimet tona vlersojmë se pergjegjësitë qe dalin nga neni 23 i Statutit të OSK-së jnaë kryer me kompetencë dhe profesionalizem.
3. **Këshilli Drejtues (KD)** , edhe për këtë si organ kyq i Odës nuk kemi gjetur ndonje parregullsi për punë e tij gjatë kësaj periudhe. Nga verifikimi i deshmive konstatuam se KD qysh ne vitin pare të zgjedhjes se tij (viti 2019) me autorizim të Kuvendit ka pergaditur të gjitha rregulloret e brendshme dhe të njejtat i janë përcjell Kuvendit për miratim duke kompletuar kështu infrastrukutrën ligjore.
Poashtu ne këtë periudhë nga KD janë miratuar Raportet financiare periodike , shqyrtimi i ankesave të antarëve ,rekrutimi i zyrtarëve administrative , riorganizimi i librave të protokoleve të OSK-së , harmonizimi i pagave për shërbimin profesional të Odës etj.

4. **Këshilli Mbikqyrës** , gjatë kësaj periudhe ka kryer përgjegjësitë që dalin nga neni 29 pika 1.1 mbikqyrja e afarizmit financiar të odës , deri sa nuk vërehet rastet për ndonjë shkelje të drejtave të antarëve të odës.
5. **Këshilli Etik , Gjyqi i Nderit dhe Prokurori i Odës** si organe të mbrojtës së profesionit dhe vet komunitetit , bazuar në raportet e Komisionit për çështje etike dhe deshmimet tjera të verifikuara e vlerësojmë se në përgjithësi janë zbatuar kompetencat që dalin nga nenet 31 , 34 dhe 35 të Statutit të Osk-së.
6. **Komisionet e përhershme** , bazuar në nenin 37 të OSK-së odëka të themeluar 6 Komisione të përhershme dhe fushveprimtaria e tyre është e përcaktuar me Rregulloren të mbrendshme të miratuara nga Kuvendi Odës.

Gjatë verifikimit të deshmive me qëllim të vlerësimit të performancës së organeve të odës me shumë jemi fokusuar në punën e komisionit për Licencim dhe komisionit për buxhet dhe financa.

Nga mostrat e perzdhura për verifikim të rasteve për licencim dhe ri-licencim të anëtarve konstatuam se komisioni ka respektuar aktet normative të përcaktuara në rregulloren për Licencim të profesionistëve shëndetësor.

Sa i përket vlerësimit të punës së komisionit për buxhet dhe financa gjetjet tona i kemi cekur në pikën I të këtij raporti si në rastet 1,2 dhe 3 që lidhen me pasqyrat financiare të periudhës.

Ndër tjera kemi analizuar shkallën e harmonizimit të buxhetit të planifikuar dhe buxhetit të realizuar të periudhës , me çka konstatuam një dallim të theksuar.

Për fund kemi sygjyerim të përgjithshme për të ardhmen që Raportet e komisioneve të jenë me përbajtësore për çështjet përkatëse të OSK-së.

Komentet e OSK-së:

PËRFUNDIM: ne në OSK, mirëpresim dhe jemi mirënjohës për gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga ana juaj me rastin e auditimit financiar dhe funksional të OSK-së për vitin 2020. Gjetjet, sygjerimet dhe propozimet e dhëna në pikat e lartëcekura (pika: 1,2,3 dhe 4), nga ana jonë do të mirren parasysh në kryerjen e punëve në të ardhmen.

Lidhur me pikën 4. Raporti i auditimit funksional të organeve të OSK-së, nuk kemi ndonjë koment shtesë.

Letrën e punuan auditoret ligjor:

Haxhi Nimanaj



Janar 2022